04/02/2025

Anastasi i Shqipërise – biri i Ngjalljes



Një artikull nga Episkopi Timotei Prahoveanu, episkop vikar i Kryepeshkopatës së Bukureshtit.

Për gati një shekull, udhëtimi i tij nëpër botë ka qenë një pelegrinazh i besimit dhe shërbimit. Nga mbi 95 vitet e jetës së tij, 65 ai i ka dhuruar me përulësi dhe përkushtim të rrallë Kishës, duke ndriçuar rrugën e besimtarëve me hirin e tij.

Një hierark me formim të jashtëzakonshëm teologjik dhe kulturor, Anastas Janullatos ishte një apostull i Ungjillit, një ndërtues paqeje dhe një dhurues i palodhur i ushqimit shpirtëror dhe material, veçanërisht në vendet e largëta afrikane.

Për më shumë se tre dekada, ai punoi me një zell të palëkundur për ringjalljen e Kishës Ortodokse të martirizuar të Shqipërisë, duke u bërë vetë një dëshmi e gjallë e Ringjalljes.

Ky ishte dhe mesazhi kryesor që ai predikonte, jo vetëm me fjalë, por më shumë me vepra, me përjetime dhe me një shpresë të thellë, të patundur, në pritje të ditës së madhe dhe të pambarimtë të Zotit.

Jeta e Kryepiskopit Anastas Janullatos shpaloset para syve tanë si një faqe sinaksari, e shkruar tashmë me shkronja drite, edhe pse, pa dyshim, shumë dëshmi dhe vepra të tjera ende të panjohura do të gjejnë vendin e tyre në këtë histori

përkushtimi dhe shenjtërie.
Ashtu si apostujt e dikurshëm, të cilëve Shpëtimtari u dha urdhër të shkonin deri në skajet e tokës për të shpallur Ungjillin, edhe ai e mori këtë shërbesë fisnike dhe iu përkushtua asaj. Është e vështirë të kuptohet se ku gjeti aq shumë burime, një fuqi dhe zell të tillë, dashuri dhe durim, për të përmbushur misionin e vërtetë – ιερά αποστολία.
Qoftë duke përshkuar vendet e Afrikës, duke sjellë dritën e besimit në shumë vende, qoftë duke marrë pjesë në kongrese, simpoziume dhe takime ekumenike, të gjitha këto përpjekje ishin vetëm një parathënie për misionin e tij më të madh: ringjalljen e Kishës Ortodokse të Shqipërisë. Me dashurinë e tij vërtet apostolike, ai e rindërtoi atë nga themelet, duke e vendosur mes Kishave Autoqefale, si një flakadan që digjet pandërprerë në bashkësinë e madhe të Ortodoksisë.
Përtej asaj që dihet tashmë për jetën e tij – misioni i jashtëzakonshëm në Shqipëri, ku ndërtoi një katedrale, selinë arkiepiskopale, institucione kishtare të nivelit më të lartë, shkolla teologjike, manastire, qendra misionare dhe kulturore, spitale, institucione bamirëse – duhet theksuar një fakt vërtet mbresëlënës: Kryepiskopi Anastas nuk u ndal vetëm te ndërtimi i tempujve të shenjtë, por rindërtoi, restauroi dhe ngriti nga themelet mbi 400 kisha dhe manastire, por mbi të gjitha, një numër të panumërt shpirtrash…
Kur mbërriti në Tiranë, fillimisht si eksark i Patriarkut të Konstandinopojës, Dimitrios, dhe më pas si udhëheqës i Kishës së Shqipërisë, që nga viti 1992, Kryepiskopi Anastas nuk u prit me solemnitetin e natyrshëm të një momenti të tillë, por me realitetin e dhimbshëm të një Kishe pothuajse të zhdukur nga historia. Pa një tempull të përshtatshëm për vendosjen e tij, ceremonia u zhvillua në një sallë të thjeshtë garash sportive, i vetmi vend i disponueshëm, sepse kishat e mbetura ishin në rrënoja, dhe shërbesat ishin dëbuar prej tyre për gati një gjysmë shekulli.
Nën regjimin ateist, Kisha e Shqipërisë ishte zyrtarisht e shfuqizuar, e fshirë nga dokumentet shtetërore dhe e dënuar në heshtje. Megjithatë, besimi nuk mundi të shuhet. Edhe në kohët më të errëta, ai mbijetoi fshehurazi në zemrat e njerëzve, si një flakë e fshehtë, e ruajtur me çmimin e vuajtjes, ndërsa çdo dëshmi publike ndëshkohej ashpër.
Në fund, fjalët e fundit të Kryepiskopit Anastas, të përsëritura edhe në shtratin e tij të sëmundjes, nuk ishin tjetër veçse: “Krishti u Ngjall!” Ai i përsëriste këto fjalë me shpresën që buronte nga një besim dhe përjetim i thellë.
Kur ata që e vizituan i thanë se shumë po luteshin për të, ai gjeti forcën të përgjigjej: “U jam mirënjohës të gjithëve!”
Si një apostull i vërtetë i Ringjalljes, Kryepiskopi Anastas Janullatos e ka përmbushur misionin e tij me një përkushtim të rrallë, duke lënë pas një trashëgimi të paharrueshme për Kishën Ortodokse dhe për të gjithë ata që patën fatin ta

njohin. Ai u bë vetë një flakadan i pashuar, një shembull i rrallë dhe pothuajse i pakrahasueshëm i shërbimit të plotë, pa frikë dhe pa pushim.
Fjalët e thëna për të në ditët e fundit të jetës së tij flasin vetë:
“Shenjtor, i Denjë, i Pavdekshëm…”
Një i pavdekshëm që do të vazhdojë të flasë, përtej kohës, për Ngjalljen…

Burimi: https://ziarullumina.ro/…/nemuritorii-care-mor…